

**“Dhuro Gjak, Shpeto jetë”: Stafi i Autoritetit të konkurrencës i bashkohet iniciativës së Kryqit të Kuq Shqiptar për dhurimin vullnetar të gjakut.**

**10.06.2011 – Tiranë:** Stafi i Autoritetit të Konkurrencës bëhet pjesë e iniciativës së Kryqit të Kuq për dhurimin vullnetar të gjakut. Ky dhurim u krye pranë ambienteve të këtij institucioni. “Dhuro Gjak, Shpeto jete”, është filozofia e Kryqit të Kuq shqiptar në perpjekjen e vazhdueshme për të ndihmuar njerezit në nevojë për gjak.

Ky është një kontribut modest për të ndihmuar komunitetin në përmirësimin e jetesës së tij. Gjaku i dhuruar do të përdoret kryesisht në ndihmë të fëmijëve talasemikë. Aktualisht rezervat e gjakut në vend janë një ndër nevojat më të mëdha të sistemit shëndetësor të vendit.

Në Tiranë janë rreth 500 fëmijë talasemike

- 1 herë në muaj ata duhet të marrin një flakon gjak.
- Ky lëng i jetës është jetik për ta. Gjakun nuk mund ta fabrikojmë. Ai sigurohet vetëm nga dhurimi..

Me 400 mililitra gjak mund të shpëtojmë jetën e një fëmije, nëse ai ka nevojë për gjakun e plotë. Po me të njëjtën sasi gjaku të dhuruar mund të shpëtojmë jetën e 3 fëmijëve, të cilët kanë nevojë për elementë të caktuar të gjakut.

Të dhurosh Gjak të Sigurt është akt human e të marrësh gjak të sigurt është një e drejtë. Dhurimi i gjakut është një akt human dhe si të gjithë aktet humane nuk ka çmim. Një shoqëri e qytetëruar ka gjithmonë dhurues gjaku.

**Autoriteti i Konkurrencës i bën thirrje të gjithë individëve që të bashkohen me nismën e Kryqit të Kuq për dhurimin e gjakut. Nëse dikush vendos për të dhuruar gjak duhet të drejtohen pranë bankës së gjakut në Tiranë në Spitalin Universitar Nënë Tereza, në Maternitetin Nr.1 dhe Nr.2 si dhe tek Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut pranë Spitalit Ushtarak apo në spitalet e ndryshme në vend.**